



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.91 dt.10.06.1997

**MBI**

**DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE PER MUAJIN PRILL 1997.**

Në bazë të legjislacionit të ndihmës dhe përkujdesjes shoqërore Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me dt.10.06.1997, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Sektorit të Mbrojtjes Shoqërore.

**VENDOSI**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **11.676 familje** me një fond prej **23.238.123 lekë**.  
Për çdo Njësi Administrative sipas relacionit.
2. Miratohet masa e ndihmës ekonomike për çdo familje për muajin prill sipas relacionit.
3. Të dalin nga skema e ndihmës ekonomike **109 familje** sipas pasqyrave të bashkëngjitura.
4. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike Pëllumb Hajdari, Ethem Ndreu, Luan Peza, Xhavit Sina, Haxhi Sula, Artur Sula, Pëllumb Blaceri, Adelina Gega, Skënder Nanaj, Gafurr Shkëmbi, Fatmira Morina, Edison Tale.
5. Të trajtohen me ndihmë të diferencuar **15 familjet** sipas relacionit.
6. Të përfitojnë ndihmë ekonomike si rast i veçantë Marigo Mico, familje me 1 antar, Nj.A.3.
7. Nuk miratohet kërkesa e Laureta Ago, Adivije Leka, Frederik Cima, Nazmi Rexhepi për të përfituar ndihmë ekonomike si rast i veçantë.

8. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1444 persona** me aftësi të kufizuar dhe **56 persona** për përkujdesje ndaj një personi me aftësi të kufizuar me një fond gjithsej prej **4.864.666 lekë**.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**